



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.32/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Violeta Husaj Rugova kryesuese, Hajriz Hoti, dhe Bujar Muzaqi, anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e shtetasit [REDACTED], me vendbanim në Zvicër, parashtruar ndaj Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të përjashtimit nga lista përfundimtare e votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 12.09.2025, mori këtë :

V E N D I M

REFUZOHET E PABAZUAR ANKESA ZLAnr 32/2025 e dates 10.09.2025, e parashtruar nga [REDACTED], me vendbanim në Zvicër, për shkak të përjashtimit nga lista përfundimtare e votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025.

Arsyetim

Më datë 10.09.2025, PZAP-i, përmes emailit zyrtar ka pranuar një ankesë ZL.Anr.32/2025 nga shtetasi [REDACTED] me vendbanim në Zvicër, kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak se i është mohuar padrejtësisht pa asnjë arsyetim të ligjshëm e drejta për të ushtruar drejtën kushtetuese për të votuar me postë nga diaspora.

Parashtruesi i ankesës thekson se ka aplikuar për votim me postë nga diaspora brenda afatit përpara datës 29 gusht 2025, dhe aplikimi iu është miratuar nga KQZ dhe si dëshmi i është dërguar ftesa e aprovimit, të cilën ishte i obliguar të bashkëngjis me materialin e votimit.

Më tej në ankesë thekson se në listën e publikuar nga KQZ me datë 28 gusht 2025, të njëjtit figuron emri si aplikues për votim me postë. Mirëpo, në listën përfundimtare emri i tij është larguar pa paralajmërim dhe pa njoftim zyrtar.

Në ankesë ka bashkangjitur si provë dëftesën e regjistrimit dhe kopjen e dokumentit të identifikimit-letërnjoftimi.

Kërkon nga PZAP-i, që të pranojë këtë ankesë si të bazuar dhe të ligjshme, të konstatojë se KQZ ka shkelur të drejtën për të votuar, si dhe të urdhëroje KQZ-në, që të rikthejë emrin e tij në listën përfundimtare të votuesve jashtë vendit.

Në përgjigje në kërkesë KQZ-ja, ka theksuar se përmes shërbimit për votues nga jashtë ka shqyrtuar aplikimin e shtetasit Nazim Kokollarit dhe pas aprovimit të kërkesës, aplikuesi është njoftuar përmes emailit, në email adresën e dhënë gjatë aplikimit [REDACTED]

Duke u bazuar në Procedurën Standarde të Veprimit për Regjistrimin e Votuesve Jashtë Kosovës të miratuar nga KQZ, pika 2,7, është bërë verifikimi i votuesve të regjistruar,

Email adresa e përdorur nga shtetas [REDACTED] nuk është përputhur me të dhënat e votuesit, pra nuk është adresë personale, e cila është në kundërshtim me nën paragrafin 4.2 të nenit 3 të Rregullores Zgjedhore Nr. 04/2025, Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës, ku kërkohej që aplikuesi të plotësojë adresën personale të emailit dhe numrin personal të telefonit mobil.

Email adresa e përdorur [REDACTED] nuk është adresë personale, për më tepër ajo tregon se i përket një personi me mbiemër tjetër nga ai i aplikuesit, dhe se pas verifikimeve kërkesa e aplikuesit është anuluar.

Paneli, pasi që shqyrtoi pretendimet ankimore konstatoi se:

-Ankesa është e pabazuar

Paneli, pasi shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi se ankesa e ankuesit është e pabazuar, pasi që parashtruesi i ankesës gjatë aplikimit të tij për regjistrim për votim jashtë Kosovës nuk i ka plotësuar kriteret e kërkuara sipas paragrafit 4 të nenit 3 të Rregullores Zgjedhore Nr. 04/2025, Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës të KQZ-së, në të cilin është përcaktuar se *"4. Kërkesa për regjistrim përmes platformës elektronike të KQZ bëhet si në vijim: 4.1. Plotëson të dhënat e adresës së banimit jashtë Kosovës: shtetin, kodin postar, qytetin, emrin e rrugës, numrin e banesës apo shtëpisë; 4.2. Plotëson email adresën personale dhe numrin e telefonit mobil personal; 4.3. fotografon njërin prej dokumenteve identifikuese të lëshuara nga Republika e Kosovës, si letërnjoftim, pasaportë ose patentë shofer, duke mos përjashtuar dokumentet me afat të skaduar; 4.4. fotografon dokumentin që dëshmon adresën e votuesit jashtë Kosovës, sikurse në nën paragrafin 4.1..."*

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndëve dhe përgjigjes së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Paneli arriti në përfundimin se parashtruesi i ankesës, gjatë aplikimit për regjistrim votim jashtë Kosovës përmes platformës elektronike të KQZ-së, nga verifikimi i këtyre dëshmive paneli vëren se Email adresa e përdorur nuk përputhet me të dhënat e votuesit, pra nuk është adresë personale, dhe si e tillë është në kundërshtim me nën paragrafin 4.2 të nenit 3 të Rregullores Zgjedhore Nr. 04/2025 "Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës", ku kërkohej që aplikuesi të plotësojë adresën personale të emailit dhe numrin personal të telefonit mobil. Email adresa e cila është [REDACTED] mbanë mbiemër të ndryshëm nga ai i aplikuesit.

Pas analizimit dhe vlerësimit të provave materiale dhe pretendimeve ankimore, PZAP konstaton se në këtë çështje administrative, drejt është vërtetuar gjendja faktike, nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të ankuesit, andaj pretendimet e ankuesit nuk janë te bazuara.

Në këto rrethana, Paneli vlerësoi se parashtruesi i ankesës nuk ka plotësuar njërin nga kriteret thelbësore të përcaktuara në kuadër të procesit të regjistrimit për votim jashtë vendit, konkretisht kriterin që lidhet me email adresën personale, kriter ky i përcaktuar shprehimisht me nenin 3 paragrafi 5 pika 5.1 të Rregullores Zgjedhore Nr.04/2025 Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës, të nxjerrë nga KQZ.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 paragrafi 3, 118 paragrafi 1, neni 119 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, lidhur me neni 3 paragrafi 5 pika 5.1 e Rregullores të sipërcituar, dhe në bazë të Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
ZL.Anr. 32/2025 më datën 12.09.2025

Kryesues e Panelit,
Violeta Husaj Rugova



KËSHILLAJURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.